



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 prill 2016
Nr. ref.:RK918/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin KI09/16

Parashtrues

Behgjet Pacolli

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, të 7 prillit 2011

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Behgjet Pacolli, individ nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësim kushtetues të moszbatimit të Rezolutës (në tekstin e mëtejme: Rezoluta) së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02 (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të 7 prillit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së moszbatimit të Rezolutës së Kuvendit, të 7 prillit 2011, përkitazi me amendamentet kushtetuese dhe me legjislacionin e nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.
4. Rezoluta në fjalë ishte nxjerrë nga Kuvendi në mbështetje të Memorandumit (në tekstin e mëtejme: Memorandumi) ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të lidhur më 6 prill 2011.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Sekretariatit të Kuvendit.
8. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi (gjyqtarë).
9. Më 17 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve bazuar në dokumentet e përmbajtura në kërkesë

10. Më 6 prill 2011, parashtruesi i kërkesës, z. Behgjet Pacolli, lider i partisë politike Aleanca Kosova e Re (AKR), z. Isa Mustafa, lider i partisë politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe z. Hashim Thaçi, lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), nënshkruan Memorandum mirëkuptimi për dalje nga kriza institucionale e krijuar në vitin 2011. Në atë memorandum, të tre udhëheqësit e partive politike ishin pajtuar për krijimin e një komisioni *ad hoc* të Kuvendit që do të hartonte ndryshimet (amendamentet) kushtetuese dhe legjislacionin e nevojshëm për të zgjedhur Presidentin e Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.

11. Më 7 prill 2011, Kuvendi miratoi Rezolutë me të cilën mbështeti memorandumun e lartpërmendur.
12. Më 22 prill 2011, Kuvendi miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nr. 04-V-12. Ky vendim ishte i bazuar edhe në Rezolutën e Kuvendit, e cila në atë rast nuk ishte zbatuar plotësisht.
13. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit i dërgoi amendamentet e propozuara në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar vlerësim kushtetues të amendamenteve të propozuara, përkatësisht nëse ato ishin në pajtueshmëri me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës.
14. Më 20 korrik 2012, Gjykata, në rastet KO29/12 dhe KO48/12, vlerësoi nëse amendamentet e propozuara ishin në pajtueshmëri me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës.
15. Amendamentet e propozuara kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës nuk ishin vënë në votim në Kuvend.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi pretendon se dështimi i Kuvendit për të miratuar këto amendamente të propozuara është shkelje e nenit 24 [Barazia para Ligjit], e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, e nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 25, pika a) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Kuvendi nuk e ka zbatuar plotësisht Rezolutën NR. 04-R-02, datë 7.4.2011, për faktin që asnjëherë nuk i ka vendosur në rend të ditës për votim amendamentet e propozuara kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, që janë vlerësuar nga Gjykata me Aktgjykimin nr. KO29/12 dhe KO48/12 të datës 20 korrik 2012. Me këtë rast, Kuvendi me mosveprim (heshtje) dhe moszbatim të Rezolutës NR. 04-R-02 ka shkelur të drejtat e pretenduara kushtetuese të parashtruesit të kërkesës”.*
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Kuvendi me moszbatimin e Rezolutës NR. 04-R-02, nuk i ka dhënë rastin deputetëve, sidomos asaj të legjislaturës së kaluar, që e kanë mbështetur këtë rezolutë për të votuar draft amendamentet kushtetuese të propozuara për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt nga populli”.*
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“... nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë nga Kuvendi me subjektet e tjera politike dhe nënshkruesit e marrëveshjes, me rastin e moszbatimit të Rezolutës NR. 04-R-02 dhe mosvënies në votim të pakos së amendamenteve për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit dhe se ka pasur pritshmëri të arsyeshme që gjatë kësaj*

legjislature, por edhe legjislaturës së kaluar të Kuvendit, këto draft amendamente të procedohen për votim në Kuvend”.

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Me moszbatimin e plotë të rezolutës dhe mosprocedimin për votim të amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, atij si person fizik dhe AKR-së si person juridik i është shkelur edhe barazia para ligjit në frymën e nenit 24 të Kushtetutës, sepse me këtë rast parashtruesi si subjekt i marrëveshjes të mbështetur nga rezoluta është vendosur në pozitë të anshmërisë dhe të pabarazisë, në raport me subjektet tjera të marrëveshjes të mbështetur nga Rezoluta NR. 04-R-02, respektivisht z. Hashim Thaçi (PDK) dhe z. Isa Mustafa (LDK)”.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Rezoluta NR. 04-R-02 e obligon Kuvendin që të respektojë afatet e parapara në marrëveshjen politike, ku përfshihet edhe ndryshimi i Kushtetutës për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit”.
22. Parashtruesi i kërkesës pohon se nuk ka ndonjë mjet juridik që ai do ta kishte shfrytëzuar për t’u ankuar ndaj moszbatimit të Rezolutës Nr. 04-R-02 në kuptimin e nenit 144.3 të Kushtetutës për të proceduar votimin e amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “... pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Rasti nr. KO29/11, ishte tërhequr nga posti i Presidentit të Republikës së Kosovës me qëllimin e zbatimit të rezolutës dhe votimit të amendamenteve të propozuara kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit”.
24. Parashtruesi pretendon se, në këtë rast, afatet kohore të përcaktuara me Ligj nuk mund të llogariten sepse bëhet fjalë për një “situatë të vazhdueshme”, sepse Kuvendi me moszbatimin e Rezolutës ka krijuar “situatën e vazhdueshme”. Për të mbështetur pretendimin e tij, parashtruesi i referohet rastit nr. KI47/10 Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë, Aktgjykim i 29 shtatorit 2010 (në tekstin e mëtejme: rasti i presidentit Sejdiu).
25. Parashtruesi pretendon: “Si palë e marrëveshjes ka pasur pritshmëri të arsyeshme që zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 të organizohen sipas rregullave të reja kushtetuese të zgjedhjes së drejtpërdrejtë nga populli”.
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata “... që të vërtetojë shkeljet e lirive dhe të drejtave të parashtruesit dhe të obligojë Kuvendin që të zbatojë Rezolutën NR. 04-R-02, duke zbatuar procedurën e mëtutjeshme të votimit të amendamenteve të propozuara për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, pa e paragjykuar rezultatin e votimit dhe duke respektuar mandatin e lirë të deputetëve dhe parimet e tjera kushtetuese”.

Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-R-02, përcakton:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet në

mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit”.

Vlerësimi i pranueshmërisë

27. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Gjykata i referohet nenit 113.1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës që përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

29. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

30. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës që parasheh:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.

31. Gjykata duhet së pari të qartësojë çështjen e juridiksionit të saj, përkatësisht të përcaktojë nëse në rastin konkret bëhet fjalë për një procedurë të paraparë me Kushtetutë dhe nëse kërkesa është dorëzuar nga një subjekt i autorizuar me Kushtetutë për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së çështjes së parashtruar.

32. Numri i subjekteve që mund të kontestojnë veprimet e Kuvendit është i kufizuar në paragrafët 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Neni 113.7 i Kushtetutës, nuk lejon procedurën *actio popularis* (Për shtjellim të mëtejme të procedurës *actio popularis*, shih rastin nr. KI117/11, *Ridvan Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 korrikut 2012).

33. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me procedurën *actio popularis* kishte përcaktuar: *“Gjykata po ashtu ka nënvizuar se Konventa nuk parasheh parashtrimin e një actio popularis për interpretimin e të drejtave që ajo i përmban ose t’iu lejojë individëve që të*

ankohen për ndonjë dispozitë të së drejtës vendore thjeshtë sepse ata konsiderojnë, pa u cenuar drejtpërsëdrejti nga ajo dispozitë, se mund të jetë në kundërshtim me Konventën” (Shih, Aksu kundër Turqisë [Dhoma e Madhe], Aplikacionet nr. 4149/04 dhe nr. 41029/04, Aktgjykim i 15 marsit 2012, paragrafi 50, dhe Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar [Dhoma e Madhe], Aplikacioni nr. 13378/05, Aktgjykim i 29 prillit 2008, paragrafi 33).

34. Në këtë aspekt, Gjykata sërish vë në spikamë përmbajtjen e paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës:

“3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(1)...

(2) Përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(4) Përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

35. Edhe nëse parashtruesi do të ishte palë e autorizuar, Gjykata po ashtu konsideron se ky lëshim nga ana e Kuvendit për ta vënë në votim ose për të mos zbatuar Rezolutën në fjalë zakonisht nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit sepse nuk është *ratione materiae* në përputhje me juridiksionin e saj, veçanërisht duke parë se nuk ka akt konkret dhe procedurë që duhet të ndiqet ashtu siç parashikohet me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
36. Gjykata vëren po ashtu se parashtruesi i kërkesës vetëm ka numëruar dhe ka përshkruar dispozitat kushtetuese dhe ato të instrumenteve të tjera ndërkombëtare përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për barazi para ligjit, mirëpo nuk ka arritur të arsyetojë se si janë shkelur ato dispozita (Shih rastin nr. KI109/14, *Ahmet Krasniqi dhe të tjerët*, Aktvendim i 20 shkurtit 2015, paragrafët 35 dhe 36).
37. Rrjedhimisht, kërkesa është paraqitur nga pala e paautorizuar dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe më tej siç specifikohet me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 17 mars 2016, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi